



**Gjykata Supreme  
e Republikës së Maqedonisë së Veriut**

**PROGRAMI I PUNËS  
të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut  
për vitin 2024**

## P ë r m b a j t j a

<b>Hyrje</b> .....	3
<b>Detyrat e programit</b> .....	4
-Administrata gjyqësore.....	6
-Kompetencat dhe organizimi i brendshëm.....	6
-Procedimi efikas dhe vendimmarrja e lëndëve.....	8
-Zbatimi i procedurave të brendshme.....	8
<b>Sektorët gjyqësor</b> .....	9
-Sektori i veprave penale.....	9
-Sektori i veprave civile.....	9
-Sektori për gjykim në afat të arsyeshëm.....	10
-Sektori i praktikës gjyqësore.....	11
-Këshillat e specializuar.....	12
<b>Burimet njerëzore</b> .....	12
<b>Transparenca dhe marrëdhëniet me publikun</b> .....	13
-Këshilli për Gjyqësor të Hapur.....	14
-Bashkëpunimi me sektorin civil dhe me mediumet.....	14
<b>Edukimi i vazhdueshëm</b> .....	15
<b>Sistemi informativ dhe digjitalizimi</b> .....	15
<b>Puna financiare</b> .....	16
<b>Puna e zyrës dhe e arkivit</b> .....	16
<b>Bashkëpunimi institucional dhe ndërkombëtar</b> .....	17
<b>Integriteti</b> .....	17
<b>Qëllimet dhe angazhimet e programit</b> .....	18

Në bazë të nenit 37 paragrafi (1) nënpika 5 të Ligjit për gjykatat, Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, më 29.02.2024, miratoi:

**Programin e punës**  
**të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut**  
**për vitin 2024**

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut është gjykatë më e lartë në Republikë dhe siguron unitetin në zbatimin e ligjeve nga gjykatat.

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, kompetencat e saj i realizon sipas Kushtetutës, ligjeve, marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare në pajtim me Kushtetutën; Rregulloren gjyqësore, Rregulloren e punës të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe sipas akteve tjera nënligjore.

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Seancën e përgjithshme:

- miraton qëndrime parimore dhe mendime juridike parimore mbi çështje të rëndësishme për sigurimin e unitetit në zbatimin e ligjeve nga gjykatat në afat prej tri muajve, dhe jo më tepër se gjashtë muaj me iniciativën e vet apo me iniciativën e kryetarit të gjykatës apo me iniciativë të seancave të gjyqtarëve apo seancave të sektorëve nga gjykata apo me iniciativën e avokatëve dhe i publikon në ueb faqen e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- jep mendime sipas propozimeve të ligjeve dhe rregulla të tjera kur me to rregullohen çështje të rëndësishme për punën e gjykatave,
- shqyrton çështje lidhur me punën e gjykatave, zbatimin e ligjeve dhe praktikën gjyqësore;
- miraton Rregullore për punën e saj;
- miraton Programin e punës së gjykatës;

- paraqet propozim në Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut për delegimin e një gjyqtari në një gjykatë tjetër;
- miraton Kodin e etikës së gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë, me propozim të Shoqatës së gjyqtarëve,
- mund të paraqesë kërkesë për ngritjen e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë së një gjyqtari apo kryetari të gjykatës;
- paraqet iniciativë për ngritjen e procedurës në Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut për përcaktimin e aftësisë së humbur të përhershme për realizimin e funksionit të gjyqtarit;
- emëron anëtarë të Këshillit për vendimmarrjen e ankesave kundër vendimit të sjellë nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në përputhje me ligjin;
- vendos mbi kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër vendimeve të këshillave të saj;
- vendos mbi kërkesa për përjashtimin e kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- shqyrton raportin e punës së saj dhe raportet e punës së gjykatave në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga aspekti i përditësimit dhe cilësia e punës, nxjerr konkluzione për to, është përgjegjëse të ndjek zbatimin e tyre dhe
- realizon edhe çështje tjera të përcaktuara me ligj.

## **1) Detyrat e programit**

Në bazë të nenit 37, paragrafi (3) të Ligjit për gjykatat me programin e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, për periudhën nga 01.01.2024 deri më 31.12.2024 definohe detyrat e punës, qëllimet dhe angazhimet nga fushëveprimi i punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut me qëllim që të sigurohet:

- Zbatimi i paanshëm i drejtësisë pavarësisht nga pozita dhe cilësia e palëve;
- Mbrojtja, respektimi dhe përparimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;
- Sigurimi i barazisë, barabarësisë, mos diskriminimit për çfarëdo baze;

- Vendosja cilësore e lëndëve në kohë në kompetencën e Gjykatës;
- Ofrimi i sigurisë juridike përmes unifikimit të praktikës gjyqësore në bazë të sundimit të drejtësisë;
- Realizimi i principeve për gjykim në afat të arsyeshëm dhe siguri i kushteve për qasjen më të shpejtë në drejtësi;
- Transparenca dhe publiku në punën e Gjykatës, për sigurimin e informimit në kohë të palëve dhe publikut për vendimet e Gjykatës;
- Zbatimi konsekuent i Kushtetutës, ligjeve dhe marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare në përputhje me Kushtetutën; ligjet proceduese dhe materiale dhe aktet nënligjore, Ligjin për gjykatat, Ligjin për shërbim gjyqësor, Rregulloren gjyqësore dhe Rregulloren e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Harmonizimi i praktikës gjyqësore dhe siguri i barazisë në zbatimin e ligjeve nga gjykatat;
- Respektimi i vendimeve definitive dhe përmbaruese të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe marrëveshjet tjera të ratifikuara në përputhje me ligjin.

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, vendimet e saj i themelon në bazë të Kushtetutës, ligjeve dhe marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare në përputhje me Kushtetutën.

Gjyqtarët e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në zbatimin e të drejtës i mbrojnë të drejtat dhe liritë e njeriut, në përputhje me nenin 2, paragrafi (2) të Ligjit për gjykatat.

Në raportin e fundit të Komisionit Evropian për përparimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, puna e Gjykatës Supreme të RMV-së përsëri është vlerësuar pozitivisht. Aktivitetet e Gjykatës Supreme të RMV-së janë vlerësuar pozitivisht edhe në Raportin e Departamentit të Shtetit dhe në raportet relevante të vendit dhe ato ndërkombëtare.

Në vitin 2024, Gjykata Supreme do të vazhdojë me aktivitetet që janë në përputhje me Raportin e Komisionit Evropian, dhe të cilat Raporti i vlerëson si masa dhe angazhime pozitive.

Në këtë kuptim, aktivitetet e vërejtura të Gjykatës Supreme japin kontribut kyç për sundimin e të drejtës, që është parakusht kryesor për pavarësinë e gjyqësorit, integritetin e

gjyqtarëve, realizimin e të drejtave të njeriut, përparimin e sistemit gjyqësor dhe luftën kundër korrupsionit.

Për realizimin e këtij qëllimi dhe në bazë të Programit të punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut (01.01.2024 – 31.12.2024), Gjykata Supreme do të vazhdojë me përparimin e praktikës gjyqësore, konsistencën e vendimeve, miratimin e qëndrimeve parimore, mendimeve juridike dhe konkluzioneve, marrjen e aktiviteteve për përfshirjen më të madhe, përparimin e transparencës, përforcimin e statusit të gjyqtarëve dhe integritetin e tyre dhe procedimin e vazhdueshëm në përputhje me dokumentet e strategjisë për reformat në sektorin e gjyqësorit dhe për luftën kundër korrupsionit.

Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjyqtarët dhe punonjësit në Gjykatë janë të obliguar të sigurojnë realizimin e Programit të përcaktuar për periudhën e shënuar.

### **1) Administrata gjyqësore**

Kryetari i Gjykatës do të menaxhojë dhe udhëheq me Gjykatën, do t'i kryejë punët nga fushëveprimi i administratës gjyqësore dhe do të organizojë punën e Gjykatës.

Kryetari i Gjykatës do të prezantojë Gjykatën dhe do të ndërmerr masa për kryerjen me rregull dhe në kohë të punëve, do të sigurojë zbatimin e Rregullores gjyqësore, do të miratojë Orarin e punës të Gjykatës, do të veprojë për parashtresat dhe ankesat e palëve dhe organeve tjera, për kërkesat e vendosjes me prioritet të lëndëve, për kërkesat për përjashtim, të parashtruara nga gjyqtarët dhe nga palët dhe do të ndërmerr veprime të tjera për të cilat është kompetent sipas Ligjit, Rregullores gjyqësore dhe Rregullores të punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Për kryerjen e punëve në mënyrë efikase, në kohë dhe në rregull të administratës gjyqësore, në përputhje me Rregulloren e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kryetari i Gjykatës mund t'ia besojë detyrat e punës zëvendësit të tij ose ndonjë gjyqtari tjetër, gjyqtarit kryetar të Sektorit, Administratorit gjyqësor apo ndonjë nëpunësi tjetër gjyqësor dhe sipas nevojës do të organizojë edhe ekipin e tij për punët e kabinetit. Në rast të pengesës ose mungesës të Kryetarit të Gjykatës do ta zëvendësojë zëvendësi i kryetarit të Gjykatës.

Kryetari i Gjykatës rregullisht thërret Seancë të gjyqtarëve për shqyrtimin e realizimit të Programit të punës së Gjykatës dhe shqyrtimin, analizën dhe ndërmarrjen e masave për

raportet e punës së Gjykatës, harmonizimin e punës së Sektorëve, dhënien e mendimeve nga kompetencat e Seancës së gjyqtarëve dhe për çështje të tjera nga puna e Gjykatës.

## **2) Kompetencat dhe organizimi i brendshëm**

Në bazë të kompetencave të saj kushtetuese dhe ligjore, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut:

- vendos në shkallën e dytë kundër vendimeve të këshillave të saj siç është përcaktuar me ligj;
- vendos në shkallën e tretë dhe të fundit mbi ankesat kundër vendimeve të gjykatave të apelit;
- vendos mbi mjete të jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve të plotfuqishme të gjykatave dhe vendimeve të këshillave të saj kur ajo është e përcaktuar me ligj;
- vendos për ndeshje të kompetencave ndërmjet gjykatave themelore të rajonit të gjykatave të ndryshme të apelit, ndeshje të kompetencave ndërmjet Gjykatës Administrative dhe një gjykate tjetër, ndeshje të kompetencave në mes Gjykatës së Lartë Administrative dhe një gjykate tjetër dhe vendos për bartjen e kompetencave vendore te këto gjykata;
- vendos mbi kërkesat e palëve dhe pjesëmarrësve tjerë në procedurën për shkeljen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, në procedurë të përcaktuar me ligj në gjykatat e Republikës së Maqedonisë së Veriut në përputhje me rregullat dhe principet e përcaktuara me Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut dhe duke u nisur nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropës për të Drejtat e Njeriut dhe
- realizon çështje tjera të përcaktuara me ligj.

Kompetencën kushtetuese dhe ligjore për unifikimin e praktikës gjyqësore dhe sigurimin në zbatimin e ligjeve nga gjykatat, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, e realizon përmes miratimit të qëndrimeve juridike dhe mendimeve juridike parimore, mendimeve juridike dhe konkluzioneve të nxjerra në:

- Seancën e përgjithshme,
- Seancën e gjyqtarëve dhe
- Seancën e sektorit.

Në pajtim me nenin 66 paragrafi (1) dhe (2) nga Rregullorja gjyqësore në realizimin e kompetencës vendore të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, sipas llojit të lëndëve dhe vëllimit të punës, Gjykata e realizon në kuadër të:

- Sektorit të veprave penale,
- Sektorit të veprave civile,
- Sektorit për gjykim në afat të arsyeshëm dhe
- Këshillave të specializuar.

Qëndrimet parimore dhe mendimet juridike parimore që i miraton Gjykata Supreme në Seancën e përgjithshme janë të detyrueshme për të gjitha këshillat e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Qëndrimet parimore të miratuara dhe mendimet juridike mbi çështje të rëndësishme për sigurimin e unitetit në zbatimin e ligjeve nga gjykatat, Gjykata Supreme detyrimisht i publikon në ueb faqen e Gjykatës.

### **3) Veprimi efikas dhe vendimmarrja e lëndëve**

Qëllimi themelor gjatë veprimit të lëndëve është që të sigurojë veprim efikas, profesional të përditësuar, të paanshëm, ligjor dhe në kohë, të lëndëve duke respektuar afatet ligjore dhe afatet për gjykim në afat të arsyeshëm në pajtim me dispozitat nga Rregullorja gjyqësore dhe Ligji për udhëheqje me qarkullimin e lëndëve në gjykatat, Rregulloren e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe procedurat e brendshme të Gjykatës, në çdo fazë të procedurës.

Regjistrimi, shpërndarja, veprimi, vendimmarrja, publikimi, përpilimi i vendimeve, dorëzimi i vendimeve, anonimizimi i vendimeve të UEB faqes së Gjykatës, do të bëhet me zbatimin e plotë dhe ekskluziv të sistemit kompjuterik të automatizuar për udhëheqjen me lëndët gjyqësore (AKMIS).

Regjistrimi i lëndëve do të bëhet sipas kohës së pranimit, ndërsa shpërndarja e lëndëve nëpër gjyqtarët do të bëhet me shpërndarjen automatike në AKMIS. Rishpërndarja automatike e lëndëve, do të bëhet vetëm në situata të përcaktuara me Rregulloren gjyqësore dhe në pajtim me Orarin vjetor të punës së Gjykatës, por edhe në ato raste rishpërndarja e lëndëve do të



bëhet ekskluzivisht me vendim të arsyetuar nga Kryetari i Gjykatës përmes modulit përkatës në AKMIS, për sigurimin e mbrojtjes së parimit të shpërndarjes automatike dhe përfshirjen e faktorit njeri gjatë ndarjes së lëndëve në punë të gjyqtarëve.

Gjyqtarët janë të obliguar të japin prioritet në vendosjen e lëndëve, të cilat me Ligj është përcaktuar se janë urgjente dhe për të cilat është dhënë prioritet nga Kryetari i Gjykatës, sidomos për lëndët që janë me interes të lartë publik dhe për të cilat është përcaktuar praktikë dhe procedurë për veprimin e përditësuar mbi të njëjtët.

#### **4) Zbatimi i procedurave të brendshme**

Zbatimi i procedurave të brendshme për punën në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut ka rëndësi kryesore për efikasitetin, përditësimin, ligjshmërinë dhe transparencën në punën e gjykatës.

Procedurat e brendshme të miratuara nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut kanë të bëjnë me punën e përgjithshme të gjykatës, përkatësisht për punën e Kabinetit të Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Seancën e përgjithshme, punën e sektorëve gjyqësor, sporteve gjyqësore, si dhe për procese të ndara gjatë udhëheqjes së lëndëve në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Procedurat e brendshme, gjithashtu kanë të bëjnë edhe me procedimin dhe vendimmarrjen e lëndëve me interes të lartë publik dhe në këtë kuptim respektimi dhe zbatimi i procedurave të brendshme jep kontribut ekskluziv nga aspekti i efikasitetit dhe reputacionit të gjykatës dhe realizimin e qëllimeve të pushtetit gjyqësor, sipas Ligjit për gjykatat.

#### **5) Sektorët gjyqësor**

##### **5.1 Sektori i veprave penale**

Sektor i veprave penale do të mbledhet dhe do të mbajë seanca të rregullta, në të cilat gjyqtarët dhe këshilltarët gjyqësorë të Sektorit detyrueshëm do të marrin pjesë në seancë dhe do të marrin pjesë në diskutimin mbi çështje të paraqitura në rendin e ditës së seancës.

Sektor do të diskutojë mbi çështje juridike dhe miratimin e mendimeve juridike dhe konkluzioneve për sigurimin e unitetit në zbatimin e ligjeve dhe harmonizimin e praktikës gjyqësore. Në fakt, do të diskutohet për sentenca të përpiluara lidhur me botëkuptimet juridike të shprehura në vendime të ndryshme konkrete.

Sektor do të sigurojë konsistencën e vendimeve, sipas praktikës veç më të krijuar gjyqësore për lëndë të caktuara.

Për përmirësimin e cilësisë së vendimeve, Sektor do të vazhdojë të diskutojë për strukturën e arsytimit të vendimeve, në mënyrë që theksi do t'i vendoset argumentimit të shkaqeve për vendimet e miratuara, qëndrime juridike të shprehura qartë, si dhe shfrytëzimin e jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Sektor i veprave penale do të organizojë mbledhje të përbashkëta me gjykatat e apelit, në të cilat do të shqyrtohen çështje për problemet që paraqiten në punën, gjykimin, ndjekjen dhe harmonizimin e praktikës gjyqësore, zvarritjen e procedurës së disa lëndëve dhe çështje me interes për punën e gjykatave në Republikën e Maqedonisë së Veriut;

Kryetarit të gjykatës do t'i propozohen masa konkrete për zgjidhjen e çështjeve të natyrës objektive ose subjektive me rëndësi për funksionimin normal të Sektorit.

## **5.2 Sektor i veprave civile**

Sektor i veprave civile do të vazhdojë me procesin e vazhdueshëm në përparimin dhe konsistencën e praktikës gjyqësore, duke përmbushur qëllimet për unifikimin e praktikës gjyqësore si një nga funksionet më të rëndësishme të Gjykatës Supreme. Në këtë drejtim, Sektor i veprave civile do të diskutojë mbi çështje juridike dhe do të miratojë mendime juridike dhe konkluzione, do të përpilojë sentenca të cilat do të publikohen në ueb faqen e Gjykatës.

Sektor i veprave civile do t'i miratojë sentencat e përpiluara të shprehura në botëkuptime juridike në vendime konkrete gjyqësore, njëkohësisht duke diskutuar për

harmonizimin dhe përforsimin e strukturës së vendimeve, me vëmendje të posaçme të argumentimit të ekspozuar.

Spektori i veprave civile do të iniciojë këshillime, seminare dhe takime me përfaqësues të gjykatave tjera, institucione juridike dhe subjekteve tjera relevante me qëllim zbatimin e ligjeve dhe përparimin e praktikës gjyqësore.

Spektori i veprave civile do të vazhdojë të veprojë në mënyrë efikase dhe me përditësim, në kuptim të kryerjes së shpejtë dhe efikase të lëndëve të arritura. Angazhim i Sektorit të veprave civile është përparimi i gjendjes me burimet njerëzore si çështje me rëndësi të madhe për funksionimin e Sektorit dhe të gjykatës.

Spektori i veprave civile, së bashku me Sektorin e praktikës gjyqësore do të thërrasin mbledhje me përfaqësues të gjykatave të apelit, në të cilat do të shqyrtohen problemet në gjykim, ndjekja dhe harmonizimi i praktikës gjyqësore dhe shkaqet për zvarritjen e procedurës për disa lëndë.

Spektori do t'iu kushtojë vëmendje të posaçme ndryshimeve të ligjeve të reja që kanë të bëjnë me gjyqësorin, në mënyrë që do të jap mendim për hyrjen në fuqi dhe zbatimin e ndryshimeve të tilla ligjore dhe do të propozojë trajnime përkatëse me qëllime edukative, që do të japin kontribut të rëndësishëm në procedimin dhe veprimin praktik.

Gjatë punës së tij, Spektori do të analizojë dhe do të konstatojë çështje të ndryshme që ndikojnë në funksionimin e rregullt të gjykatës si tërësi dhe do të propozojë masa për tejkalimin e problemeve dhe përmirësimin e gjendjes.

### **5.3. Spektori për gjykim në afat të arsyeshëm**

Spektori për gjykim në afat të arsyeshëm ndjek vazhdimisht punën me lëndët e Sektorit, do të propozojë masa konkrete për zgjidhjen e çështjeve të natyrës objektive ose subjektive me rëndësi për funksionimin normal të Sektorit, do të diskutojë mbi çështje të caktuara juridike dhe do të miratojë mendime juridike dhe do të nxjerrë konkluzione për sigurimin e barazisë në zbatimin e ligjeve dhe unifikimin e praktikës gjyqësore.

Spektori për gjykim në afat të arsyeshëm do të miratojë sentencat e përpiluara me botëkuptime juridike të shprehura në vendime konkrete, do të sigurojë konsistencë të vendimeve në Sektor.

Për përmirësimin e cilësisë së vendimeve, Spektori për gjykim në afat të arsyeshëm do t'i riafirmojë konkluzionet e nxjerra të Sektorit, do të diskutojë për harmonizimin e strukturës së

arsyetimit të vendimeve, duke vendosur theks në argumentin bindës për shkaqet e vendimeve të miratuara dhe qëndrimet juridike të shprehura qartë.

Spektori për gjykim në afat të arsyeshëm do të organizojë mbledhje të përbashkëta me Byronë për përfaqësimin e RM në GJEDNJ, ku do t'i shqyrtojë çështjet rreth ndjekjes dhe harmonizimit të praktikës gjyqësore, zvarritjen e procedurës për lëndë të caktuara dhe çështje tjera me interes për punën e gjykatave në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe do të avancojë bashkëpunimin me institucione ndërkombëtare relevante përkatësisht GJEDNJ lidhur me praktikën gjyqësore për gjykim në afat të arsyeshëm.

#### **5.4. Spektori i praktikës gjyqësore**

Spektori i praktikës gjyqësore e harmonizon punën e Sektorëve dhe Seancën e përgjithshme në realizimin e obligimeve që kanë të bëjnë me evidencën dhe studimin e praktikës gjyqësore sipas nenit 72 të Rregullores gjyqësore.

Harmonizimi i praktikës gjyqësore, si një nga funksionet më të rëndësishme të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në këtë kuptim Spektori i praktikës gjyqësore do të promovojë qasje pro aktive me sektorët tjerë dhe do të vazhdojë me qasjen aktive në pjesën e unifikimit të praktikës gjyqësore.

Në drejtim të plotësimit të qëllimit themelor të Sektorit të praktikës gjyqësore, sidomos i rëndësishëm është përforcimi i bashkëpunimit ndërmjet sektorëve dhe stimulimi i bashkëpunimit me gjykatat më të ulëta përmes takimeve me gjykatat e apelit për shqyrtimin e disa çështjeve juridike në drejtim të harmonizimit në zbatimin e ligjeve nga gjykatat.

Spektori i praktikës gjyqësore vazhdon edhe me ndjekjen e praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe do të përgatit Buletin të praktikës gjyqësore dhe Përmbledhje të vendimeve gjyqësore që i boton Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

#### **5.5 Këshillat e specializuar**

Në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, sipas Orarit të punës së gjykatave është formuar Këshill i specializuar për vendimmarrjen e ankesave kundër vendimeve të Gjykatës Administrative sipas nenit 62 të Ligjit për konteste administrative, me propozim për mbrojtjen për shkak të veprimit joligjor; Këshill i specializuar që vendos mbi ankesa të një kandidati që nuk është zgjedhur gjyqtar përkatësisht kryetar gjykate sipas nenit 49, paragrafi (5) të Ligjit për këshillin gjyqësor, për ankesa kundër vendimit të Këshillit gjyqësor për rivlerësimin e një gjyqtari, përkatësisht të një kryetari gjykate sipas nenit 96 paragrafi (5) të Ligjit për këshillin gjyqësor dhe për kërkesë për përsëritjen e procedurës me rastin e aktgjykimit përfundimtar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg sipas nenit 73 paragrafi (8) dhe paragrafi (11) të Ligjit për këshillin gjyqësor.

## **6) Burime njerëzore**

Me Vendim të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, është përcaktuar që funksionin e gjyqtarit në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut ta realizojnë 28 gjyqtarë. Megjithatë, në gjykatë funksionin e gjyqtarit e realizojnë 15 gjyqtarë, nga të cilët njërit prej gjyqtarëve me kërkesën e tij, i është pushuar funksioni i gjyqtarit në periudhën prej më 31.12.2021 deri më 31.01.2026. Në momentin, funksionin e gjyqtarit e realizojnë 14 gjyqtarë, përfshirë edhe kryetarin e Gjykatës.

Në qoftë se merret parasysh edhe periudha e kaluar me vendet e punës të cilat janë të zbrazura për baza të ndryshme, si dhe vendet e punës së gjyqtarëve të cilat asnjëherë nuk janë plotësuar, numri i tanishëm i gjyqtarëve në gjykatë aspak nuk i plotëson nevojat.

Duke pasur parasysh pozitën kushtetuese të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, kompetencat e saj, punën e Seancës së përgjithshme, punën e katër sektorëve (Sektorin e veprave penale, Sektorin e veprave civile, Sektorin për gjykim në afat të arsyeshëm dhe Sektorin e praktikës gjyqësore), ndërmerren aktivitete të vazhdueshme për zgjedhjen e gjyqtarëve të rinj në Gjykatën Supreme, që është një nga angazhimet kyçe të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Gjithashtu, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, si gjykatë më e lartë e shtetit, duhet të jetë e pajisur në tërësi me kuadër cilësor profesional, ku më së shumti duhet të përfshihen nëpunësit gjyqësor të kategorisë B-këshilltar të pavarur gjyqësor me përvojë

shumëvjeçare pune në pajtim me kriteret ligjore dhe posedimin e njohurisë dhe profesionalizmit përkatës.

Gjithashtu, puna e administratës gjyqësore është segment ekskluzivisht i rëndësishëm për punën efikase dhe në kohë të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, që e imponon nevojën për përforcimin e kapaciteteve të administratës gjyqësore nga aspekti i burimeve njerëzore.

Në fakt, përforcimi i kapaciteteve është i nevojshëm edhe në Qendrën e informatikës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut si dhe në sportelet gjyqësore. Me rëndësi ekskluzive për Gjykatën Supreme është edhe ri pajisja e administratës gjyqësore me nëpunës gjyqësor/këshilltarë gjyqësor, me nëpunës gjyqësor/referentë të lartë gjyqësor, këshilltar për furnizime publike, këshilltarë-të informatikës, si dhe përkthyes gjyqësor.

Përforcimi i kapaciteteve të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut është vazhdimisht një nga angazhimet dhe qëllimet e programit në kuptim të përforcimit të potencialit institucional në pajtim me parimet e efikasitetit dhe sigurimin e drejtësisë cilësore.

## **7) Transparenca dhe marrëdhënia me publikun**

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë, zotohet sidomos për njoftimin në kohë të publikut për procedurat gjyqësore për të cilat është evident interesi publik dhe prania e medimeve.

Përmes çiltërsisë, transparencës dhe dhënies në kohë të informacioneve të sakta dhe relevante për Gjykatën në procedura të caktuara mund të mbrohet dhe të rruhet reputacioni i Gjykatës dhe të rritet besimi i publikut ndaj Gjykatës.

Në anën tjetër, informimi i drejtë dhe në kohë i publikut do të pengojë publikimin e informacioneve të pasakta nga medimet, që do të mund të kenë ndikim të dëmshëm si për Gjykatën, ashtu edhe për palët dhe interesin e tyre.

Për sigurimin e detyrës së këtij programi në Gjykatë rregullisht do të publikohen njoftime në ueb faqen e Gjykatës, ndërsa përmes Zyrës për marrëdhënie me publikun do të mundësohet qasje e publikut të interesuar për informacione dhe procedura aktuale që udhëhiqen në Gjykatë.

Në ueb faqen e Gjykatës, sipas Rregullores së punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, rregullisht do të publikohen njoftime lidhur me punën e Seancës së përgjithshme dhe sektorëve gjyqësor, qëndrimet e miratuara parimore dhe mendimet juridike parimore, konkluzionet dhe të gjitha informacionet lidhur me punën e Seancës së përgjithshme dhe seancave të Sektorëve.

Vendimet e sjella anonimizohen sipas Ligjit për udhëheqjen me qarkullimin e lëndëve në gjykata dhe të njëjtat do të publikohen në ueb faqen e Gjykatës, në mënyrë që mundësohet qasja e publikut në punën e Gjykatës.

## **7.1 Këshilli për Gjyqësor të Hapur**

Postulati themelor, i punës së Këshillit për Gjyqësor të Hapur është përparimi i transparencës së gjykatave dhe institucioneve gjyqësore si një kontribut i rëndësishëm për llogari dhënien dhe efikasitetin në jurisprudencë.

Deklarata për Gjyqësor të Hapur, e sjellë nga Këshilli për Gjyqësor të Hapur, si një pjesë e programit Partneritet për qeverisje të hapur paraqet angazhim që ka për qëllim të kontribuojë ndaj pjesëmarrjes së zmadhuar civile sa i përket punës së gjyqësorit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në bazë të këtyre angazhimeve, Këshilli për Gjyqësor të Hapur mori aktivitete që kanë të bëjnë me përgatitjen e Planit aksionar për Gjyqësor të Hapur, përgatitjen e Strategjisë së komunikimit dhe aktivitete të përkushtuara për përparimin e ueb-faqes së gjykatave.

Këshilli për Gjyqësor të Hapur e miratoi Planin e ri aksionar për 2024 – 2026. Në kuadër të aktiviteteve të tij Këshilli për Gjyqësor të Hapur punon në përgatitjen e Propozim- Strategjisë për komunikim, miratimi i të cilës nga Këshilli do të zbatohet në muajin shkurt 2024. Për Strategjinë e komunikimit përgatitet edhe një Plan aksionar me aktivitete konkrete për zbatimin e obligimeve që rezultojnë nga Strategjia.

## **7.2. Bashkëpunimi me sektorin civil dhe me mediumet**

Zyra për marrëdhënie me publikun ndërmerr vazhdimisht aktivitete për përparimin e transparencës në pajtim me aktivitetet e Këshillit për Gjyqësor të Hapur dhe angazhimet e përcaktuara me Deklaratën për Gjyqësor të Hapur.

Në këtë drejtim, vazhdon bashkëpunimi intensiv i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut me organizatat e qytetarëve, të cilat janë pjesë përbërëse e Këshillit për Gjyqësor të Hapur dhe me organizatat civile angazhimi i të cilëve është respektimi i denjë i principit të sundimit të së drejtës, sistem gjyqësor të përparuar, pavarësinë e gjyqësorit dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

Zyra për marrëdhënie me publikun do të komunikojë rregullisht dhe do të bashkëpunojë me përfaqësuesit e medimeve dhe organizatat e qytetarëve, të cilat e ndjekin punën e gjyqësorit, si dhe me publikun më të gjerë civil.

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, do të bashkëpunojë sidomos me Këshillin për medime gjyqësore, në kuadër të bashkëpunimit të vazhdueshëm dhe qëllimeve të përbashkëta për përparimin e transparencës së gjyqësorit dhe bashkëpunimin midis profesionit gjyqësor dhe bashkësisë së medimeve.

## **8) Edukimi i vazhdueshëm dhe përsosja profesionale**

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, siguron përsosjen profesionale të gjyqtarëve, nëpunësve – udhëheqës, profesionistëve dhe nëpunësve administrativo – teknik gjyqësor, policisë gjyqësore dhe punonjësve në shërbimin gjyqësor në gjykatë. Edukimi i vazhdueshëm dhe përsosja profesionale paraqet një nga angazhimet kyçe të Gjykatës Supreme në kuptim të përsosjes edukative të kuadrit gjyqësor.

Edukimi i vazhdueshëm dhe përsosja profesionale realizohet përmes trajnimeve, seminareve, konferencave dhe ngjarjeve edukative, si dhe përmes qasjes në literaturë edukative në bibliotekën e gjykatës.

Biblioteka gjyqësore është e furnizuar me një numër të duhur të ekzemplarëve të ligjeve, rregullave, komenteve, si dhe me literaturë profesionale. Biblioteka, si një kontribut i rëndësishëm edukativ në realizimin e përgatitjes teorike dhe praktike të punës, vazhdimisht do të shtohet me botime të reja dhe me literaturë profesionale.



## **9) Sistemi informatik dhe digjitalizimi**

Gjykata Supreme Republikës së Maqedonisë së Veriut angazhohet dhe ndërmerr aktivitete për sistem informatik dhe digjitalizim të përparuar dhe për zbatimin konsekuent të Rregullores për mënyrën dhe funksionimin e sistemit informatik të gjykatave në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Qendra për teknologji informatike, e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut është kompetente për menaxhimin me sistemin e automatizuar kompjuterik për udhëheqjen me lëndët gjyqësore, portalin gjyqësor dhe bazat e të dhënave që burojnë nga puna e gjykatave.

Qendra për informatikë e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, përkatësisht shërbimet, organizon mbështetjen informatike të punës së gjykatës, kujdeset për infrastrukturën informatike, aplikacionet dhe bazat e të dhënave, të cilat i udhëheq dhe i përdor gjykata, i ndjek dhe i zbaton proceset e reja teknologjike, kujdeset për mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave dhe të tërë sistemit, në mënyrë sistematike i arkivon dhe në mënyrë përkatëse i rruan të dhënat, i trajnon gjyqtarët dhe punonjësit e shërbimit gjyqësor në gjykatë dhe iu jep ndihmë profesionale gjykatave më të ulëta.

Pajisja harduerike-softuerike nga fusha e IKT siguron funksionimin pa pengesë të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të gjykatave dhe të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut vazhdimisht ndërmerr aktivitete për sigurimin e kushteve organizuese, teknike dhe të kuadrove për funksionimin e teknologjisë informatike të gjykatës.

## **10) Puna financiare**

Në kuadër të buxhetit të miratuar nga Këshilli i buxhetit gjyqësor për vitin vijues, do të sigurohet realizimi në kohë i procedurave për furnizimet publike në pajtim me dispozitat e Ligjit për furnizime publike dhe me menaxhimin ekonomik dhe përkatës të mjeteve financiare.

Në vitin 2024, do të vazhdojnë aktivitetet dhe procedurat për përmirësimin e kushteve të punës në Gjykatë si një nga faktorët kryesor për realizimin e funksionimit pa pengesë të Gjykatës.

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, do të vazhdojë me angazhimet e saj për sigurimin e mjeteve të përcaktuara ligjore për gjyqësorin. Sigurimi i mjeteve të përcaktuara ligjore për punën e gjyqësorit paraqet një nga faktorët kryesor për pavarësinë e pushtetit gjyqësor dhe garanci për pavarësinë financiare, funksionale dhe ligjore të gjyqësorit.

### **11) Puna në zyre dhe në arkiv**

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, lidhur me arkivimin e lëndëve dhe dokumentimin vepron sipas dispozitave të Rregullores gjyqësore, Ligjit për material arkivor dhe rregullave për punë në zyre dhe në arkiv.

Për këtë qëllim, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, do të vazhdojë me aktivitetet për zbatimin konsekuent të obligimeve ligjore që nënkuptojnë zgjedhjen e materialit arkivor dhe dokumentar, rregullimin e materialit arkivor dhe dokumentar, evidentimin (regjistrim dhe përshkrim) të materialit arkivor, kategorizimin e materialit arkivor, regjistrimin e materialit dokumentar të cilit i ka kaluar afati i rruajtjes, asgjësimin e materialit të propozuar dokumentar, vendosjen, rruajtjen, mbrojtjen, sigurimin dhe shfrytëzimin e materialit arkivor dhe dokumentar në hapësirë përkatëse, pajisje standarde, mjete tekniko-teknologjike dhe dorëzimin e materialit arkivor për rruajtjen e përhershme në Arkivin Shtetëror.

### **12) Bashkëpunimi institucional dhe ndërkombëtar**

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, do të vazhdojë me përparimin e bashkëpunimit në plan ndërkombëtar, sidomos në aspektin e angazhimeve regjionale për gjyqësor të pavarur dhe të çiltër, procedimin sipas rekomandimeve të Bashkimit Evropian dhe të faktorëve ndërkombëtar relevant, të cilët vazhdimisht i japin mbështetjen gjyqësorit vendor, si dhe në aspektin e përparimit të praktikës gjyqësore nga aspekti i praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, do të ketë bashkëpunim institucional intensiv me institucionet juridike mbi çështjet që kanë të bëjnë me punën e gjyqësorit, me fokus të veçantë të transparencës dhe pavarësisë gjyqësore, realizimin e qëllimeve të vendosura në Strategjinë re të sektorit për zhvillimin e gjyqësorit 2024-2028 dhe aktivitetet komplementare me Këshillin gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut lidhur me rekomandimet e Komisionit Evropian.

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, do të vazhdojë me pjesëmarrjen dhe organizimin e tryezave të rrumbullakëta dhe konferencat regjionale dhe ndërkombëtare të përkushtuara për integritetin, efikasitetin dhe transparencën e gjyqësorit.

### **13) Integriteti**

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut në procedimin, vendimarrjen dhe në punën e saj, e zbaton Kodin e etikës së gjyqtarëve, të miratuar nga Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe standardet etike të përcaktuara në dokumentet ndërkombëtare për pavarësinë e gjyqësorit.

Sipas principeve të Kodit të etikës së gjyqtarëve, pavarësia e gjyqësorit është parakusht për sundimin e të drejtës dhe paraqet garanci themelore për gjykim të drejtë.

Paanshmëria është me rëndësi esenciale për realizimin përkatës të funksionit të gjyqtarit. Integriteti është një atribut i nderit dhe drejtësisë. Mirësjellja dhe sjellja përkatëse – kulturore e gjyqtarit është me rëndësi esenciale për realizimin e të gjitha aktiviteteve të funksionit të gjyqtarit.

Sigurimi i barazisë në procedurën për të gjithë në gjykatë është me rëndësi esenciale për realizimin përkatës të funksionit të gjyqtarit. Profesionalizimi dhe përgjegjshmëria janë parakusht për realizimin përkatës të funksionit të gjyqtarit. Çdo kundërvajtje e principeve nga Kodi do të konsiderohet si kundërvajtje e këtij Kodi.

Çdo gjyqtar është i detyruar të njoh dhe të mbrohet nga rastet që joshin në konflikt interesi dhe korrupsion.

Në bazë të kompetencave të saj kushtetuese dhe ligjore dhe në bazë të Programit vjetor për punën e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gjykata Supreme vazhdimisht do të veprojë në pajtim me dokumentet e strategjisë për reforma në sektorin e

gjqësorit dhe për luftën kundër korrupsionit, si dhe në pajtim me politikën e integritetit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe planin me aktivitetet për luftën kundër korrupsionit.

#### **14) Qëllimet dhe angazhimet e programit**

Për realizimin me sukses të këtij programi është i domosdoshëm angazhim dhe aktivizimi i gjyqtarëve dhe të gjithë punonjësve në Gjykatë, me qëllim që të arrihen detyrat e përcaktuara dhe qëllimet e programit.

Qëllim themelor i programit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut është veprimi transparent, efikas dhe i përditësuar dhe vendimmarrja në pajtim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore.

Për realizimin e këtij qëllimi, Gjykata do të vazhdojë me realizimin e kompetencave të saj në pajtim me proceset e reformave dhe me sugjerimet dhe rekomandimet në Raportin e Bashkimit Evropian.

Në këtë drejtim, Gjykata do të vazhdojë me përparimin e praktikës gjyqësore, konsistencën e vendimeve; miratimin e qëndrimeve parimore, mendimeve juridike dhe konkluzioneve; ndërmarrjen e aktiviteteve për përfshirjen më të madhe, përparimin e transparencës; përforsimin e statusit të gjyqtarëve dhe integritetin e tyre; statusin e shërbimit gjyqësor dhe veprimin e vazhdueshëm në pajtim me dokumentet strategjike për reforma në sektorin e gjyqësorit dhe për luftën kundër korrupsionit.

Një nga qëllimet themelore të programit është edhe përforsimi i pozitës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut në pajtim me drejtimit strategjike dhe në bazë të principit të pavarësisë së gjyqësorit.

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, do të vazhdojë me aktivitetet për bashkëpunimin e thellë me të gjithë faktorët nga sektori i jurisprudencës, ndërsa me qëllim përparimin e përgjithshëm të gjendjes në gjyqësorin dhe përforsimin e rolit dhe pozitës së Gjykatës Supreme në pajtim me përcaktimet kushtetuese.

Në këtë kuptim, Gjykata Supreme do të vazhdojë në mënyrë intensive të ndërmerr aktivitete për kompletimin e numrit të gjyqtarëve në tërësi, rritjen e numrit të nëpunësve gjyqësor, përparimin e sistemit kompjuterik dhe efikasitetin e Trupit punues për standardizim,

përpjekjet e vazhdueshme për punë transparente në pajtim me parimet për gjyqësor të hapur, pjesëmarrjen në përgatitjen e vendimeve ligjore dhe dokumenteve strategjike që kanë të bëjnë me jurisprudencën dhe vazhdimin e bashkëpunimit regjional dhe ndërkombëtar.

Programi i punës së Gjykatës për vitin 2024, do të fillojë të zbatohet nga dita e miratimit të tij.

**ПРЕТСЕДАТЕЛ НА ВРХОВНИОТ СУД НА  
РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
KRYETARJA E GJYKATËS SUPREME TË REPUBLIKËS SË  
MAQEDONISË SË VERIUT**

**Besa Ademi**